



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 7
28.01.2013

NR. VENDIMI 4
23.05.2013

V E N D I M
“PËR KONFISKIMIN E PASURIVE”

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë e përbërë nga:

KODIAN KURUSHI	GJYQTAR
DRITAN HALLUNAJ	GJYQTAR
NERTINA KOSOVA	GJYQTARE

Asistuar nga sekretare gjyqësore **Ermira Terbuni**, në Tiranë, në seancë gjyqësore, sot më 23. 05. 2013 mori në shqyrtim, kërkesën që ju përket palëve:

KËRKUES: Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, Përfaqësuar nga **Prokurori Edvin Kondili**.

- KUNDER:** 1- **Te paditurit V.(V.) B.**, i biri i B. dhe i D., i dtl. xxx, lindur në xxx dhe banues në xxx Rruga “xxx”, Pall. xx, shk. x, ap.x, përfaqësuar nga avokati **A.L.**, anëtar i dhomës së avokatisë, xxx.
2. **Te paditurit B.B.**, i biri i A. dhe i S., e dtl. xxx, lindur në xxx dhe banuese në xxx Rruga “xxx”, Pall. xx, shk. x, ap. x përfaqësuar nga avokati **D.R.** anëtar i dhomës së avokatisë, xxx.
3. **Te paditurës D.B.**, e bija e Sh. dhe e F., e dtl. xxx, lindur në xxx dhe banuese në xxx Rruga “xxx”, Pall. xx,

shk. x, ap.x, përfaqësuar nga avokatët **A.L.** dhe **D.R.**
anëtar të dhomës së avokatisë, xxx.

OBJEKTI: **Konfiskim Pasurie**

BAZA LIGJORE: **Ligji nr. 10192 datë 03. 12. 2009 “Për parandalimin dhe Goditjen e Krimet të Organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”,**

Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës përfaqësuesi i Prokurorisë kërkoj:

Pushimin e gjykimit të kërkesës për konfiskim pasi prokuroria hoqi dorë nga gjykimi i kërkesës.

Revokimin e masës së sekuestros për pasurinë e paluajtshme të llojit llogari bankare në shumën xxx (xxx) lekë e ndodhur në Bankën xxx me numër llogarie xxx datë xxx.

Përfaqësuesit e palës së paditur: U dakorduan me kërkesën e paraqitur nga prokuroria në bisedimet përfundimtare.

Gjykata, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të prokurorit, provat e paraqitura nga palët në gjykim dhe si degjoi kërkesën e tyre përfundimtare

V Ë R E N

Gjykimi i çështjes për konfiskimin e llogarisë bankare në shumën **xxx** (xxx) lekë e ndodhur në Bankën xxx me numër llogarie xxx datë xxx duhet të pushohet për shkak se prokuroria hoqi dorë nga gjykimi i kërkesës për konfiskim dhe kërkoj pushimin e gjykimit.

Gjendja e akteve të sjella në gjykim nga prokuroria

Prokuroria për Krimet e Rënda Tiranë më datë xxx ka paraqitur në gjykatë kërkesën për konfiskimin e shumës **xxx** (xxx) lekë e ndodhur në Bankën xxx me numër llogarie xxx datë xxx. Kërkesa për konfiskimin e shumës së parave ndaj të paditurve është sjellë në gjykatë si rrjedhojë e një vendimi të mëparshëm të dhënë nga gjykata për sekuestrimin e disa pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme si rezultat i kërkesës së paraqitur nga prokuroria.

Në shqyrtimin e kërkesës për sekuestrimin e pasurive ndaj të paditurve ka rezultuar se në Prokurorinë për Krime të Rënda Tiranë kishte mbërritur materiali hetimore nga Drejtoria e Mardhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme me qëllim hetimin pasuror ndaj shtetasit V. alias V.B.

Sipas këtij materiali shtetasi V. (V.) B. është dënuar në xxx nga Gjykata e Apelit xxx me vendimet nr. xxx datë xxx dhe vendimin nr. xxx datë xxx respektivisht me x e x vjet burgim, për kryerjen e veprës penale të “Shfrytëzimit të prostitucionit në rrethana rënduese”, parashikuar si krim nga legjislacioni penal italian. Gjykata e Rrethit Gjyqësor xxx me vendimin e saj nr. xxx datë xxx ka vendosur njohjen e vendimit penal xxx të formës së prerë nr. xxx datë xxx duke e konvertuar dënimin sipas ligjit penal shqiptar për shtetasin shqiptar V. alias V.B. me x vjet burgim për veprën penale të “Shfrytëzimit të prostitucionit në rrethana rënduese”, parashikuar si krim nga neni 114/a i Kodit Penal Shqiptar.

Sipas këtij vendimi shtetasi V.(V.) B. nga muaji xxx i vitit xxx ka organizuar në bashkëpunim trafikimin e shtetaseve xxx xxx xxx dhe xxx xxx nga xxx, xxx, xxx e më pas në xxx, xxx. Më pas këto shtetase janë keqtrajtuar duke u detyruar të ushtrojnë prostitucion në xxx dhe të gjitha fitimet janë marrë nga i dënuari dhe bashkëpunorët e tij shtetasi xxx R.Ç. dhe shtetasja xxx N.S.

Vepra penale e *“Shfrytëzimit të prostitucionit në rrethana rënduese”*, parashikuar si krim nga neni 114/a i Kodit Penal Shqiptar, për të cilin është dënuar shtetasi V. alias V.B. përfshihet në kategorinë e veprave penale të parashikuara nga neni 3/1 i ligjit nr. 10192 datë 03. 12. 2009 *“Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurive”*. Për këtë shtetas dhe personat e lidhur me të sipas nenit 3/2 të këtij ligji është kryer hetim pasuror nga Prokuroria Për Krimet e Rënda dhe në përfundim të hetimit pasuror, pasi janë evidentuar pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme në gjykatë është paraqitur kërkesa për aplikimin e masave të parashikuara nga ky ligj.

Nga aktet e verifikimeve pasurore, lidhur me shtetasin V.B. dhe personat e tjerë të lidhur me të rezultoi se ai disponon pasuri të shumta të fituara prej vitit xxx e në vazhdim. Koncretisht sipas shkresës nr. xxx datë xxx të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, procesverbalit datë xxx për këqyrjen dhe marrjen e dokumentave dhe shkresës nr. xxx datë xxx të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme xxx, shkresave nr. xxx datë xxx dhe nr. xxx datë xxx të Drejtorisë Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, shkresa nr. xxx datë xxx e Bankës xxx dhe shkresa nr. xxx datë xxx e Bankës xxx, rezulton se shtetasit V.B., B.B. (i ati), D.B. (e ëma), kanë në pronësi

pasuritë të cilat janë vënë në sekestrim më pas me vendimin e gjykatës së shkallës së parë “Për Krimet e Rënda”.

Më konkretisht Gjykata e shkallës së parë Për Krimet e Rënda me vendimin nr. xx datë xxx për sekestrimin e pasurive që dyshohet se rrjedhin nga veprimtari kriminale të parashikuara nga ligji nr. 10 192 datë 03. 12. 2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” ka vendosur:

Pranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës për Krime të Rënda duke urdhëruar sekestrimin e këtyre pasurive:

- 1- Pasuria me nr. xxx, zona kadastrale nr. xxx, volumi xx, faqja xx, apartament banimi xxx m², Rruga « xxx », shkalla x, kati x, ap xx, xxx, blerë në datën xxx me kontratën nr. xxx, në emër të shtetasit B.B.
- 2- Pasuria me nr. xxx, zona kadastrale nr. xxx, volumi x, faqja xxx, apartament banimi xx m², Rruga « xxx », pall nr xx, shkalla x, kati x, ap xx, xx, blerë në datën xxx, në emër të shtetasit B.B.
- 3- Pasuria me numër rendor xxx, zona kadastrale nr. xxx, regjistri nr. xxx, Apartament banimi me sipërfaqe dy dhoma e një guzhinë, Rruga « xxx » , pall xx, shk x, ap xx, xx, blerë në datë xxx me kontratën nr. xxx, në emër të shtetasit B.B.
- 4- Pasuria me numër rendor xxx, zona kadastrale nr. xxx, regjistri nr. xxx, apartament banimi me sipërfaqe xxx m², Rruga « xxx » , kati i xxx, xxx, blerë në datë xxx me kontratën nr. xxx, në emër të shtetasit B.B.
- 5- Pasuria me numër rendor xxx, zona kadastrale nr. xxx regjistri nr.xxx, sipërfaqe prej xxx m², Rruga « xxx » , xxx, blerë në datë xxx me kontratën nr. xxx, në emër të shtetasit D.B.
- 6- Pasuria me numër rendor xx, zona kadastrale nr. xxx regjistri nr. xxx, Lokal me sipërfaqe ndërtimore xxx m² dhe sipërfaqe oborri xxx m², shesh funksional i lokali, sipërfaqe totale trualli xxx m², ndodhur në rrugën « xxx » , pranë xxx, xxx, blerë në datë xxx me kontratën nr. xxx, në emër të shtetasit D.B.
- 7- Pasuria me numër rendor xxx, zona kadastrale nr. xxx regjistri nr. xxx, apartament banimi një dhomë e një guzhinë dhe ambiente ndihmëse me sipërfaqe prej xxx m² dhe trualli që i takon xxx m², Rruga « xxx » , xxx, blerë në datë xxx me kontratën nr. xxx, në emër të shtetasit V.(V.) B.
- 8- Pasuria me nr. xxx, zona kadastrale nr. xxx, volumi xx, faqja xx, apartament banimi me sipërfaqe xx m², Lagjia xxx, xxx, nr. xx, shk x, kati x, ap x, xxx, blerë në datën xxx me kontratën nr. xxx, në emër të shtetasit B.B.
- 9- Pasuria me nr. xxx, zona kadastrale nr. xxx, volumi xx, faqja xx,

apartament banimi me sipërfaqe xx m², Lagjia xxx, nr. xx, shk x, kati x, apartamenti xx, xxx, blerë në datën xxx me kontratën nr. xxx, në emër të shtetasit B.B.

10- Mjeti i llojit autoveturë, marka xxx, tipi xxx, me numur shasie xxx, me targa xxx, blerë në datën xxx nga shtetasi V.B. i cili e ka importuar në xxx në datën xxx.

11- Mjeti i llojit autoveturë, marka xxx, tipi xxx, me targa xxx, me numër shasie xxx, blerë në datë xxx, në pronësi të shtetasit B.B.

12- Mjeti i llojit autobus, marka xxx, tipi xxx me targa xxx, me numër shasie xxx, blerë na datën xxx, në pronësi të shtetasit V.B.

13- Llogaritë bankare pranë Bankës xxx në emër të shtetasve B.A. B. dhe D.Sh.B. me numrin bazë xxx hapur në datën xxx dhe me numrin bazë xxx hapur në datën xxx:

- Llogari kursimi lidhur me numrin bazë xxx në monedhë xxx në shumën xxx (xxx) xxx.

- Llogari rrjedhëse dhe tre depozita me afat në monedhë xxx lidhur me numrin bazë xxx përkatësisht në shumat xxx (xxx) xxx, depozitë me afat një vit xxx (xxx) xxx, depozitat me afat tre muaj xxx (xxx) xxx dhe xxx (xxx) xxx.

- Llogari rrjedhëse dhe dy depozita me afat, në monedhë xxx lidhur me numrin bazë xxx përkatësisht në shumat xxx (xxx) lekë, depozita me afat gjashtë muaj xxx (xxx) xxx dhe xxx (xxx) xxx.

14- Llogaritë bankare pranë Bankës xxx në emër të Shtetasve B.A.B. dhe D.Sh.B. me numë rxxx hapur në datën xxx në shumën xxx (xxx) xxx si dhe një depozitë në shumën xxx (xxx) xxx.

15- Llogaritë bankare pranë Bankës xxx në emër të Shtetasit B.A.B. i me numër xxx në shumën xxx (xxx) lekë.

Vendimi i gjykatës është vënë në ekzekutim nga përmbarimi dhe pasuritë janë marrë në administrim nga administratorët e agjensisë së administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara. Më pas pala e paditur pasi është vënë në dijeni të vendimit të gjykatës i është drejtuar prokurorisë duke i paraqitur prova shkresore të cilat sipas vlerësimit që i ka bërë prokurori kanë përlligjur marrjen e një vendimi nga prokuroria për kryerjen e një ekspertimi kontabël prej saj.

Ekspertët kontabël të caktuar nga prokuroria më datë 28. 12. 2012 kanë paraqitur me shkrim në prokurorinë “Për Krimet e Rënda” aktin e ekspertimit kontabël të kërkuar nga prokuroria. Prokuroria pasi ka vlerësuar pëmbajtjen e aktit të ekspertimit kontabël me vendimin e datës xxx ka vendosur pushimin e pjesshëm të procedimit pasuror në ngarkim të të paditurit V.(V.) B., shuarjen e masës së sekuestros së pasurive të shtetasve B. dhe D.B. të vendosur me vendimin e gjykatës me nr. x datë xxx dhe kthimin e pasurive të të paditurve përveç shumës xxx (xxx) xxx e ndodhur në Bankën xxx me numër llogarie xxx

datë xxx.

Shqyrtimi gjyqësor

Në gjykimin e kërkesës për konfiskimin e shumës **xxx** (xxx) xxx e ndodhur në Bankën xxx me numër llogarie xxx datë xxx, përfaqësuesit e palës së paditur paraqitën në gjykatë si provë shkresore dy deklarata të dhëna para Drejtorisë së Policisë xxx datë xxx nga shtetasi xxx Th.S. nga përmbajtja e të cilave rezultoi se shtetasit V.B. dhe vëllai i tij A.B. kanë qenë të punësuar tek deklaruesi respektivisht:

Shtetasi V.B. ka punuar për periudhën xxx – xxx dhe ka përfituar nga puna shumën xxx dr në ditë.

Shtetasi A.B. ka punuar për periudhën xxx – xxx dhe ka përfituar nga puna shumën xxx dr në ditë.

Duke u bazuar vetëm në përmbajtjen e deklarimit të dhënë nga shtetasi xxx Th.S. pa u konfirmuar ky deklaram me asnjë provë tjetër prokuroria në bisedimin përfundimtar pasi ka konvertuar shumën e monedhës xxx me atë shqiptare për periudhën xxx deri në xxx ka arritur në konkluzionin se të dy vëllezërit kanë fituar nga puna e tyre si emigrant në xxx shumën prej xxx (xxx) lekë. Rrjedhimisht sipas prokurorisë shuma e fituar nga të dy vëllezërit për ligjin shumën e parave të kërkuar për tu konfiskuar nga gjykata dhe si pasojë prokuroria hoqi dorë nga gjykimi i kërkesës për konfiskim duke kërkuar pushimin e gjykimit.

Gjykata vlerëson se duke u bazuar në nenin 201/1 të Kodit të Procedurës Civile gjykimi i kësaj çështje duhet të pushohet për shkak të heqjes dorë nga gjykimi i kërkesës së bërë nga prokuroria. Gjykata i referohet Kodit të Procedurës Civile pasi neni 5/2 i ligjit nr. 10192 datë 03. 12. 2009 "***Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurive***" parashikon:

“Verifikimet, hetimet dhe gjykimi sipas këtij ligji, mbështeten në rregullat procedurale të këtij ligji dhe plotësohen nga rregulla të përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile”.

Në rastin konkret ligji i posacëm nuk e parashikon shprehimisht rastin se kur gjykata mund të disponojë me një vendim për pushimin e gjykimit, por në këtë rast gjykata do të bazohet në Kodin e Procedurës Civile. Pra kur paditësi (në rastin konkret prokurori) heq dorë nga drejta e gjykimit të çështjes për konfiskim gjykata duhet të vendos pushimin e gjykimit.

Gjykata vlerëson se pavarësisht përmbajtjes së deklaratave të dhëna nga shtetasi xxx para një drejtorie policie në xxx, të cilat janë të pakonfirmuara,

prokuroria nuk duhet të merrte për bazë në llogaritjen e shumës së fituar nga puna si emigrant në xxx të ardhurat e fituara nga shtetasi A.B., pasi ky shtetas nuk ka qenë palë në këtë proces gjyqësor. Si rrjedhim të ardhurat e përfituara nga puna si emigrant i shtetasit A.B. nuk duhet të përfshiheshin në llogaritjen e kryer nga prokuroria.

Shkresa e Agjensisë së Administrimit të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara datë xxx drejtuar Gjykatës së shkallës së parë "Për Krimet e Rënda" Tiranë.

Agjensia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara i ka paraqitur gjykatës së shkallës së parë "Për Krimet e Rënda" Tiranë një shkesë me nr. xxx prot. datë xxx ku i kërkon gjykatës një mendim mbi ekzekutimin e vendimit datë xxx nga Prokuroria e Krimeve të Rënda për pushimin e pjesshëm të procedimit pasuror nr. xx të vitit xxx në ngarkim të shtetasit V.B.

Siç e përmendëm më lart prokuroria pasi ka marrë vendimin e gjykatës për sekuestrimin e pasurive të përmendur më lart gjatë verifikimeve të kryera prej saj ka vendosur pushimin e pjesshëm të procedimit pasuror duke e mbështetur vendimin e saj në nenet 24/1 dhe 287/1 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 3/4, 24/1/b, 12/6 të ligjit nr. 10192 datë 03. 12. 2009 "***Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurive***".

Gjykata vlerëson se referimi i prokurorit në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale për pushimin e pjesshëm të procedimit pasuror dhe konstatimin prej tij të shuarjes së masës së sekuestrimit të dhënë me vendimin e gjykatës është i gabuar.

Më lart gjykata pasqyroi marrëdhëniet që ka ligji i posaçëm nr. 10192 datë 03. 12. 2009 "***Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurive***" me procedimin penal dhe Kodin e Procedurës Penale. Sipas nenit 5 paragrafi i dytë i ligjit të posaçëm të gjitha verifikimet, hetimet, gjykimet mbështeten në rregullat që janë vendosur në këtë ligj dhe plotësohen nga rregullat e përcaktuara nga Kodi i Procedurës Civile. Pra vetë ky ligj përjashton mundësinë e përdorimit për analogji të Kodit të Procedurës Penale.

Gjithashtu prokuroria pasi ka pushuar pjesërisht procedimin pasuror ka konstatuar shuarjen e masës së sekuestrimit të pasurive për të cilat ishte vendosur edhe pushimi pasuror. Gjykata vlerëson se bazuar në ligjin nr. 10192 datë 03. 12. 2009 "***Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurive***" nuk është prerogativë (kompetencë) e prokurorisë që të konstatojë shuarjen e masës së sekuestrimit të pasurive të vendosur më parë me një vendim gjykate. Në nenin 27 të ligjit të posaçëm janë parashikuar llojet e vendimeve dhe subjektet që i

marrin këto vendime për pasuritë që i nënshtrohen sekuestrimit dhe konfiskimit. Më konkretisht neni 27/1 i ligjit nr. 10192 datë 03. 12. 2009 "***Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurive***" parashikon :

Kundër vendimit të gjykatës për sekuestrimin e pasurisë, zgjatjen e afatit të masës së sekuestrimit, revokimit apo shuarjes së masës së sekuestrimit mund të bëhet ankim në gjykatën e një niveli më të lartë, sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile.

Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se gjykata është i vetmi subjekt i ngarkuar nga ligji që mund të vendos ndër të tjera edhe shuarjen e masës së sekuestrimit të vendosur prej saj.

Në përfundim gjykata vlerëson se gjykimi i kësaj çështje gjyqësore duhet te pushohet per shkak te heqjes dorë nga gjykimi i kërkesës per konfiskim nga prokuroria.

PËR KËTO ARSYE .

Gjykata bazuar në nenin 201/1 të Kodit të Procedurës Civile dhe në nenet 26, 27 e vijues të ligjit nr. 10192 datë 03. 12. 2009 "***Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurive***"

V E N D O S I

- Pushimin e gjykimit të çështjes gjyqësore regjistruar në Gjykatën e shkallës së parë "Për Krimet e Rënda" Tiranë me numër regjistri themeltar xx datë regjistrimi xxx me objekt konfiskimin e Llogarisë bankare pranë Bankës xxx në emër të shtetasve **B.A.B.** dhe **D.Sh.B.** me numrin bazë xxx hapur në datën xxx në shumën **xxx** (xxx) lekë.
- Revokimin e masës së sekuestrimit të vendosur në Llogarinë bankare pranë Bankës xxx në emër të shtetasve **B.A.B.** dhe **D.Sh.B.** me numrin bazë xxx hapur në datën xxx në shumën **xxx** (xxx) lekë.
- Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen prokurorisë.
- Urdhërohet zyra e përmbartimit xxx dhe administratori i llogarive bankare z. V.P. të ekzekutojnë këtë vendim.
- Kundër vendimit lejohet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë

brenda 5 ditëve duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes së tij.
U shpall në Tiranë më datë 23. 05. 2013.

SEKRETARE

Ermira TERBUNI

GJYQTAR

Klodian KURUSHI